



P Z A P  
I P Ž P

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA  
IZBORNİ PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.166/2025

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Kymete Kicaj kryesuese, Skender Çoçaj dhe Arsim Hamzaj, anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, kundër Koalicionit AAK-Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, NISMA-Nisma Socialdemokrate, Konservatorët, Intelektualët, me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 09 Shkurt 2025, në seancën e panelit të mbajtur me datë 26.01.2025, mori këtë:

#### V E N D I M

Pranohet e bazuara ankesa e Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, Anr.166/2025 e datës 23.01.2025,

II. Koalicionit AAK-Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, NISMA-Nisma Socialdemokrate, Konservatorët, Intelektualët, me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, i shqiptohet dënim i gjelbëri më gjelbëri në lartësi prej 3,500.00 (tresmijepesëqind) euro.

III. Detyrohet Koalicionit AAK-Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, NISMA-Nisma Socialdemokrate, Konservatorët, Intelektualët, me seli në Prishtinë, që gjelbën e shqiptuar si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

#### A r s y e t i m

Me datë 23.01.2025 PZAP ka pranuar ankesën Anr.166/2025 nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me të cilën pretendon se më datë 22.01.2025, aktivistë të Lëvizjes Vetëvendosje në Suharekë në rrugën “Brigada 123” kanë identifikuar banerët/posterët e vendosur në hapësirat/rrugët publike, të kandidatëve për deputetë Albana Bytyqi dhe Driton

Maliqi, nga radhët e Koalicionit AAK-Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, NISMA-Nisma Socialdemokrate, Konservatorët, Intelektualët

Sipas parashtruesit të ankesës me këtë veprim kandidatët dhe subjekti politik PDK kanë bërë shkelje të nenit 34, paragrafi 1 nën paragrafi 1.2, të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës-LZP, ku parashihet se “*Vendosja e njoftimeve, pllakateve dhe posterëve, ose përndryshe vendosja e emrave të tyre ose sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave në apo mbi rrugët publike, në shenjat publike të trafikut brenda ose jashtë hapësirave ose ndërtesave të zëna ose ndryshe që shfrytëzohen nga organizatat ndërkombëtare ose brenda ose ne hapësirat private pa lejen e pronareve ose shfrytëzuesve.*”

Si provë ka bashkangjitur, fotografi që dëshmon vendosjen e banerave/posterave në kundërshtim me LZP.

Në përgjigje në ankesë të paraqitur me datë 24.01.2025, Subjekti Politik Koalicioni AAK, Nisma dhe Lista Ideal, theksohet se i kundërshton në tërësi pretendimet e Subjektit Politik LVV, ngase ato janë të pa bazuara dhe në asnjë moment nuk provojnë inkriminimin e këtij koalicioni në shkeljet e pretenduara nga subjekti ankues.

Fillimisht, duhet theksuar se, bazuar në fotografinë e paraqitur si provë nga subjekti politik LVV, në ankesën e saj, konstatohet se posterët në fjalë janë vendosur në hapësira reklamuese, të cila kanë qenë të instaluara dhe funksionale edhe para nisjes së fushatës zgjedhore. Kjo hapësirë shfrytëzohet rregullisht për qëllime reklamimi dhe nuk përbën shkelje të dispozitave ligjore të cituara.

Për më tepër nga ana e Koalicionit AAK, Nisma dhe Lista Ideal për posterët e tillë ka lidhur kontratë për shfrytëzimin e këtyre hapësirave reklamuese, rrjedhimisht kanë marrë Iejen e nevojshme për shfrytëzimin e kësaj hapësire reklamuese.

Si provë në përgjigje, Koalicioni AAK, Nisma dhe Lista Ideal, kane theksuar se kane Kontratën për shfrytëzimin e hapësirës reklamuese;

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi ankesat gjeti se:

Anesa është e bazuar

Paneli ka vërtetuar se nga fotografitë e ofruara si provë nga parashtruesi i ankesës, të cilat gjenden në shkresat e lëndës, në mënyrë të padyshimtë ka konstatuar se kandidatet për deputet Albana Bytyqi dhe Driton Maliqi, të Koalicionit AAK-Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, NISMA-Nisma Socialdemokrate, Konservatorët, Intelektualët, në Suharekë në rrugën “Brigada 123”, kanë shfrytëzuar jashtëligjshëm dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore hapësirat publike konkretisht hapësirat/rrugët publike pa marrë leje nga organet kompetente të Komunës së Suharekës. Një veprim i tillë është në kundërshtim me nenin 34, paragrafi 1 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës LZP, konkretisht neni 34, paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 i LZP-së parashesh: “*1. Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalojen nga bërja e ndonjërisë si në vijim: 1.2 vendosja e njoftimeve, pllakateve dhe posterëve, ose përndryshe, vendosja e emrave të tyre*

*ose e sloganave në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave, në apo mbi rrugët publike, në shenjet publike të trafikut, brenda ose jashtë hapësirave ose ndërtesave të zëna ose, ndryshe, që shfrytëzohen nga organizatat ndërkombëtare, ose brenda ose në hapësirat private pa leje e pronarëve ose shfrytëzuesve.*

Ndërsa nga përgjigja në ankesë, e Koalicionit AAK-Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, NISMA-Nisma Socialdemokrate, Konservatorët, Intelektualët, e cila i referohet se kane lidhur kontratë për shfrytëzimin e këtyre hapësirave reklamuese, rrjedhimisht kanë marrë Lejen e nevojshme për shfrytëzimin e kësaj hapësire reklamuese, Paneli ka vërejtur se nuk është lëshuar leje për shfrytëzim të përkohshëm të këtyre hapësirave publike për vendosjen e reklamave, dhe se nuk kanë e bashkangjitur kontratën si provë në përgjigje në ankesë.

Neni 120 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të LZP-së thekson se në rast se PZAP, konstaton se ka ndodhur shkelje e të këtij ligji ose e rregullave të KQZ-së, mundet të vendosë një gjobë ndaj një subjekti politik, në vlerë deri në pesëdhjetëmijë (50,000.00) Euro. Përveç kësaj një veprim i tillë sanksionohet edhe me nenin 24 paragrafi 6 nën paragrafi 6.1 Rregullës Nr.01/2024, ku përcaktohet se "subjekti politik që është përfitues i fondeve për financimin e subjekteve politike përmes Buxhetit të Republikës së Kosovës dënohet me gjobë deri në njëzetmijë (20,000.00)euro.

Paneli, me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rr Ethanat si në vijim: natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë, shkallën dhe peshën e shkeljes, se veprimi që përbën përsëritje të shkeljes për nga natyra është i njëjtë apo njashëm, subjektit politik që ka bërë shkelje të legjislacionit zgjedhor, apo ka bërë shkelje të legjislacionit edhe në proceset e mëparshme zgjedhore, që konsiston në faktin se Koalicioni AAK-Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, NISMA-Nisma Socialdemokrate, Konservatorët, Intelektualët, ka qenë i njofuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës.

Nga arsyet e theksuara si me lart, e në kuptim të nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2, nenit 118 paragrafi 1, neni 120 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3, të LZP-së, nenit 10 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 të Rregullores Nr.01/2024 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.166/2025 më datë 26.01.2025



*Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.*